



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____.____.2024

**PROCESVERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOSNDARJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT NË LOTE ME OBJEKT: “BLERJE BINDERI PËR
SHTRIMIN E RRUGËVE URBANE, BASHKIA DIVJAKË”**

I mbajtur sot, më datë _____.____.2024, nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje binderi për shtrimin e rrugëve urbane, Bashkia Divjakë”, me fond limit: **63 709 480 (gjashtëdhjetë e tre milion e shtatëqind e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë pa Tvsh**, nga e cila: **8 461 615 (tetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa Tvsh nga të Ardhurat e Bashkisë Divjakë dhe 55 247 865 (pesëdhjetë e pesë milion e dyqind e dyzetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa Tvsh nga Granti.**

Burimi i financimit: **Granti + Të ardhurat e Bashkisë Divjakë.**

Për vitin 2024: 15 483 668 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa Tvsh, nga e cila: **8 461 615 (tetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa Tvsh nga të Ardhurat e Bashkisë Divjakë dhe 7 022 053 (shtatë milion e njëzetë e dy mijë e pesëdhjetë e tre) lekë pa Tvsh nga Granti.**

Për vitin 2025: 28 225 812 (njëzetë e tetë milion e dyqind e njëzetë e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekë pa Tvsh nga Granti.

Për vitin 2026: 20 000 000 (njëzetë milion) lekë pa Tvsh nga Granti.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 630 600 (gjashtëqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 16.04.2024 është 101.03.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Referuar Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në zbatim të neneve të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari, kemi të bëjmë me të njëjtën familje mallrash, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori.

Së dyti, duke u nisur nga nevoja e Autoritetit Kontraktor, e cila dikton në blerjen e mallrave objekt prokurimi të domosdoshme për asfaltimin e rrugëve urbane të Bashkisë Divjakë, si edhe kryerjen e punimeve në disa Njësi Administrative të Bashkisë Divjakë në një afat kohor prej 6 muajsh, që për më tepër ndodhen në distanca të gjata nga njëra-tjetra, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do ti duhet të presë furnizimin e njërit mall nga njëri operator dhe furnizimin e mallit tjetër nga operatori tjetër, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave.

Së treti, mallrat e kërkuar në këtë procedurë prokurimi, janë të domosdoshëm që të jenë paketë, pasi plotësojnë njëra tjetrën dhe bëjnë të mundur realizimin e këtyre punëve sa më efektive dhe duke sjellë në përfundimin me sukses të kontratës brenda afateve të përcaktuara.

Në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së i ndryshuar, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së i ndryshuar, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër, legjislacioni i prokurimit publik, njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte furnizimin e kërkuar i cili nuk mund të copëzohet. Theksojmë se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

Theksojmë se kjo procedurë është një procedurë e cila realizohet në mënyrë të përvitshme nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Divjakë dhe për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash, ndër vite është realizuar e përqendruar në një kontratë.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

NJËSIA E PROKURIMIT